

Dr. Lorenc AGALLIU

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

FORMIMI I ARKIVISTIT SI DOMOSDOSHMËRI PËR PËRSOSMËRINË E PUNËS ME DOKUMENTE

***Përmbledhje:** Figura e arkivistit është e lidhur ngushtë me traditën, kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe trashëgiminë e saj brezave të ardhshëm. Sa më i përgatitur profesionalisht të jetë një arkivist aq më evident bëhet pasqyrimi i kësaj trashëgimie. Nevoja për arkivistë të kualifikuar ka qenë kurdoherë e domosdoshme. Megjithëse arkivistika njihet përgjithësisht si shkencë manuale, kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund t'i përqafojë ndryshimet teknologjike. Një arkivist i mirëformuar është gjithnjë një kapacitet i shtuar përballë dokumentacionit bashkëkohor dhe në vazhdim. Për të qenë një arkivist i specializuar nuk mjafton të jesh një arkivist tradicional, të kesh asimiluar programin bazë të njohurive në fushën arkivore. Sot një arkivist i specializuar duhet të jetë i aftë t'i thyejë barrierat e ngritura midis dokumentit arkivor dhe studiuesit, midis traditës dhe teknologjisë së avancuar, midis dëshirës për hapjen e arkivave dhe garantimit të informacionit. Profesioni i arkivistit, sot më shumë se kurrë, ka nevojë për harmonizim të teorisë me praktikën, të parimeve bazë të arkivistikës, të disiplinave të ndryshme me arkivistikën dhe historinë.*

Fjalë kyçe: Arkivist, arkivistikë, formim profesional, trajnim arkivor

***Abstract:** The archivist figure is appointed to the tradition, culture and the preservation of cultural heritage and its legacy to future generations. The more professionally prepared an archivist is, the more evident the reflection of this legacy becomes. The need for qualified archivists has always been a necessity. Although archivistics is generally recognized as a manual science, this does not mean that it cannot embrace technological change. A well-informed archivist is always an added capacity to protect in the face of contemporary and on-going documentation. In order to be a specialized archivist it's not enough to be a traditional archivist, nor to have learned the base program of knowledge in the archivist's field. Today a specialized archivist must be capable of breaking the risen barriers between the archival document and the researcher, between tradition and advanced technology, between the will to open archives and the information guarantee. The archivist's profession, today more than ever, needs harmony between theory and practice, basic principles of archiving, various disciplines with archiving and history.*

Keywords: Archivist, archivistics, professional training, archival training

Hyrje

Shpesh në tryezat kombëtare dhe ndërkombëtare është theksuar nevoja e specializimit të arkivistëve, standardizimi i praktikave të punës arkivore dhe rritja profesionale e tyre. Profesionit i arkivistit, si të gjithë profesionet që lidhen me mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e informacionit, ka nevojë për një kulturë solide të përgjithshme dhe të hapur. Në mënyrë të përgjithshme në dobi të aktivitetit të përditshëm, arkivisti ka nevojë të ketë njohje të veprimtarisë së institucioneve publike, fushës së veprimtarisë së tyre, detyrave, kompetencave, historikut në nivel qendror dhe lokal të fondkrijuesve etj. Më të domosdoshme këto njohuri bëhen sidomos kur kemi të bëjmë me institucione apo fonde arkivore që kanë mbyllur veprimtarinë e tyre. Në këtë rast, arkivisti do të duhet t'i kombinojë teknikën e punës arkivore me dijet që ai ka marrë dhe merr në mënyrë të përditshme nga shkencat e tjera, me qëllim që të dijë të përballet me problemet që has gjatë përpunimit të dokumentacionit. Në mënyrë specifike, profesionit i arkivistit lidhet me praktikën, përvojën, përshtatjen dhe vënien në shërbim të profesionit të njohurive që ai zotëron.

Praktika të formimit të arkivistëve

Detyrimi për shkollimin e arkivistëve ka lindur si nevojë e shkencave të tjera për kërkime arkivore. Në Evropë domosdoshmëria për arkivistë të formuar ka lindur që në shek. XVIII, kryesisht në vendet si Itali, Francë, Spanjë e me radhë. Shkollat evropiane më të njohura sot për përgatitjen e arkivistëve është ajo franceze - Shkolla Kombëtare e Kartave (*École Nationale des Chartes*), e cila funksionon si e tillë që prej vitit 1821. Në Francë, që prej vitit 1850, të gjithë arkivistët që rekrutohen, duhet detyrimisht të kenë një diplomë të kësaj shkolle. Në Evropën e zhvilluar marrja në punë e arkivistit funksionon nëpërmjet një rekrutimi të brendshëm, ku pas seleksionimit të kandidatëve, bazuar në formimin dhe njohuritë në fushën e arkivistikës, bëhet përzgjedhja e tyre.

Në vendin tonë që prej vitit 1997 përgatitja e arkivistëve është kthyer në një disiplinë universitare. Shumica e punonjësve të Arkivit Qendror Shtetëror kanë përfunduar studimet e larta në Degën e Historisë dhe Arkivistikës por, me sa duket, edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Përtej mësimave teorike të njohjes së metodave e teknikës, një pjesë shumë e rëndësishme e kohës për arkivistin e ardhshëm, duhet të shërbejë për punë praktike, punë të drejtuar apo stazh në një arkiv lokal e qendror, për t'i provuar metodat dhe përvetësuar përdorimin e teknikës arkivore. Kjo metodë do ta shënonte formimin e arkivistit që gjatë studimeve teorike të tij e në vazhdimësi.

Duhet pranuar se vitet e fundit pozicioni i arkivistit në institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal në vendin tonë ka ardhur duke u

stabilizuar. Kjo më shumë ka ardhur si rezultat i mosndryshimeve në nivel politik të drejtuesve të institucioneve sesa dëshirës së mirë për të mos ndryshuar arkivistin e institucionit. Gjithashtu, për t'u veçuar në këtë drejtim është puna mjaft e mirë e Drejtorisë së Përgjithshme e Arkivave për trajnimin e arkivistëve dhe vendosmëria për vazhdimësinë e tyre në punë. Deri para pak vitesh lëvizja e shpeshtë e arkivistëve nga detyra ka sjell dëme të pariparueshme në nivelin e ruajtjes fizike dhe përpunimit të dokumentacionit. Largimi pa motiv nga detyra i arkivistëve bën *nul* përpjekjet e institucioneve përgjegjëse për trajnimin e arkivistit, për të cilët është harxhuar kohë dhe burime njerëzore për përgatitjen dhe rritjen profesionale të tij.

Nevoja për të pasur arkivistë të specializuar nuk duhet të jetë monopol i arkivave qendrore, por edhe i arkivave lokale, atyre të institucioneve vendore etj. Në këtë drejtim, prej vitesh, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nëpërmjet strukturave të saj ka organizuar trajnime për kualifikimin e arkivistëve. Një nga trajnimet më të rëndësishme të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, gjykuar nga kohëzgjatja, numri i pjesëmarrësve dhe kurrikula e trajnimit, është ai i vitit 2008, trajnim ky i cili u krye në bashkëpunim me Arkivat Federale të Zvicrës. Në këtë trajnim njëmuajor morën pjesë 35-40 arkivistë të DPA me apo pa përvojë në fushën e arkivistikës. Risia e këtij trajnimi ishte se në të merrnin pjesë edhe arkivistë nga arkivat e vendeve fqinje të rajonit si Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova. Trajnime të arkivistëve janë kryer edhe në nivel ndërkombëtar, ku një pjesë e mirë e arkivistëve të DPA-së janë trajnuar në programin tremujor; “*Stage Technique International d’Archives*” (STIA) në Paris Francë.¹

Vitet e fundit Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave i ka kushtuar një vëmendje të veçantë trajnimit të arkivistëve të institucioneve qendrore e vendore. Një punë e mirë është bërë në këtë drejtim, drejt formimit profesional dhe përgatitjes së sekretar-arkivistëve me njohuritë bazë mbi legjislacionin arkivor, normat tekniko-profesionale, përpunimin e dokumenteve etj. Këto seminare të vazhdueshme duket se kanë dhënë efektin e duhur në drejtim të përmirësimit të punës arkivore, çka vihet re në sasinë e dokumenteve të përpunuara dhe dorëzuara në arkivat shtetërore, cilësinë e përpunimit të dokumentacionit të institucioneve fondkrijuese, por edhe në shërbimin arkivor. Angazhim të veçantë Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ndërmoi në kuadër të projekteve STAR-1 dhe STAR-2, të qeverisë shqiptare me partnerë të huaj, ku u vunë në zbatim projekt-pilote për përmirësimin e përpunimit dhe shërbimit të dokumenteve arkivore, si dhe të trajnimit të sekretar-arkivistëve të institucioneve të qeverisjes lokale në 61 bashkitë e vendit.

¹ Stazhi ndërkombëtar për arkivat në Paris funksionon që nga viti 1951. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është prezantuar me arkivistët e saj që nga viti 1985 dhe deri në vitin 2009, ku janë trajnuar 21 arkivistë të DPA-së.

Për zbatimin e reformës administrative territoriale që synonte riorganizimin e njësive të qeverisjes vendore, qeveria shqiptare që në vitin 2013 nisi një projekt që synonte mirëfunksionimin dhe rritjen e ofrimit të shërbimeve, zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale dhe periferitë në institucionet e qeverisjes vendore. Në kuadër të realizimit me sukses të këtij projekti, gjatë vitit 2017-2018 u organizuan trajnime arkivore teorike-praktike me të gjithë arkivistët e institucioneve të qeverisjes vendore në nivel kombëtar. Ky trajnim arkivor kishte si objektiv kryesor përgatitjen e sekretar-arkivistëve të institucioneve të qeverisjes vendore me njohuritë bazë në fushën e legjislacionit arkivor dhe të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Trajnimet u kryen bazuar mbi një program të plotë, i cili synonte asimilimin e të gjitha njohurive mbi arkivistikën, duke filluar me ligjin për arkivat, normat tekniko-profesionale dhe metodologjike si dhe kodin deontologjik të arkivistit e, po ashtu, gjatë trajnimit u kryen mjaft orë punë praktike që përfshinte përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të institucioneve shtetërore nga vinin vetë arkivistët.

Të dhëna statistikore mbi rezultatet e trajnimit gjatë Projektit STAR-2, të sekretararkivistëve të institucioneve të qeverisjes lokale.²

Qyteti/Qarku	Numri i arkivistëve pjesëmarrës	Numri i arkivistëve të testuar dhe kualifikuar	Pjesëmarrja në testin final
Berat	29	19	19
Dibër	44	39	37
Durrës	22	18	18
Elbasan	63	43	40
Fier	44	41	38
Gjirokastrë	37	30	25
Korçë	41	32	32
Kukës	32	26	24
Lezhë	32	29	26
Shkodër	48	30	23
Tiranë	55	31	38
Vlorë	40	27	27
Totali	487	365	347

² Final Report. *Capacity building for lokal governments' archiving*, f. 20.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se numri i arkivistëve pjesëmarrës në këtë projekt është i konsiderueshëm. E, po ashtu, edhe numri i arkivistëve që u certifikuan është domethënës, pasi 85 % e këtyre punonjësve sot gjenden në punë dhe kanë treguar rritje të nivelit profesional në punën me dokumentet dhe sidomos në procesin e klasifikimit të dokumenteve. Rezultatet pozitive të këtij trajnimi masiv të punonjësve të njësisë të qeverisjes vendore duken qartë në rritjen e nivelit të cilësisë së përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve të dorëzuara në Arkivat Shtetërore Vendore.

Në vazhden e trajnimeve lidhur me fushën arkivore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) prej së paku tre vjetësh po kryen trajnime arkivore në drejtim të formimit të dokumenteve, evidentimit, përpunimit tekniko-shkencor, ekspertizës së vlerës së ruajtjes së dokumenteve dhe procese të tjera që lidhen me arkivistikën dhe punën arkivore. Vetëm gjatë vitit 2019 u trajnuan dhe morën pjesë në seminare rreth 282 punonjës. Organizimi i këtyre seminareve ishte mjaft i vlefshëm për punonjësit, sidomos për ata që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në procesin e përpunimit tekniko-shkencor të dokumenteve, por edhe për punonjësit që merren me detyrat e sekretarisë.

Për çfarë trajnimi ka nevojë një arkivist?

Për fillim dëshiroj të theksoj se arkivisti ka nevojë për një kualifikim tej standardeve tip apo model. Një arkivist i mirë ka nevojë për një kualifikim që iu përshtatet aftësive të tij, profilit të punës, llojit të dokumentit që ai ruan, përpunon dhe shërben. Përgatitja e arkivistëve sipas nevojave të institucionit dhe sipas periudhave të ndryshme historike apo proceseve të punës në arkivin qendror sot është domosdoshmëri. Gjatë formimit të tij profesional, arkivisti duhet t'i thellojë njohjet e tij me një periudhë të caktuar historike, me vendet, personazhet, jetën politike-ekonomike e shoqërore etj. Pra, nëse përgatitim një arkivist të periudhës së mbretërisë shqiptare (1928-1939) apo të periudhës së regjimit komunist (1945-1990) ai duhet ta njohë mjaft mirë kontekstin historik të kohës, figurat kryesore politike udhëheqëse, veprimtarinë politike të shtetit shqiptar gjatë këtyre periudhave, marrëdhëniet diplomatike të shtetit shqiptar me vendet fqinje etj. Një arkivist, njohës shumë i mirë i gjuhës osmane apo latine, nuk do të ishte i kompletuar nëse ai punon me dokumente në këto gjuhë, nëse nuk do të kishte njohuri në fushën e historisë. Puna e tij do të ishte jorezultative dhe produkti i cunguar. Ndërthurja e dijeve do ta bëjë arkivistin më të aftë për ta përgatitur sa më mirë dokumentacionin për shfrytëzim e, po ashtu, arkivisti do të jetë i aftë të japë ndihmë dhe kontribut, kryesisht te studiuesit e shumë për shfrytëzimin sa më mirë të dokumentacionit që gjendet në arkiv për këtë

periudhë historike, apo dhe për përgatitjen e mjeteve të informacionit për fondin e dhënë.

Disi më e komplikuar është puna përgatitore për kualifikimin dhe formimin e arkivistëve të arkivave shtetërore vendore. Në rastin e formimit të këtyre arkivave, e nevojshme do të ishte njohja dhe përgatitja e arkivistit së pari me njohuri bazë mbi natyrën e dokumenteve që ruhen në këto arkiva, e sidomos njohja e veprimtarisë së institucioneve të mbyllura, kryesisht të institucioneve të qeverisjes lokale që kanë vepruar pas vitit 1945. Me rëndësi të veçantë do të ishte formimi i arkivistëve për njohjen e institucioneve të tilla si: Komiteti e Partisë së Punës, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor i Rrethit/Qytetit, Këshilli Popullor i Fshatit të Bashkuar, ndërmarrjeve apo kooperativave bujqësore, ndarja territoriale e vendit etj. Njohja e strukturave organizative të këtyre institucioneve, funksionet dhe kompetencat e tyre për ushtrimin e veprimtarisë do ta ndihmonin arkivistin për përgatitjen e dokumentacionit për përpunimin tekniko-shkencor dhe përgatitjen e mjeteve të informimit për këto fonde. Arkivisti duhet të jetë në gjendje ta njohë kontekstin historik dhe administrativ të formimit të dokumentit, edhe për faktin se një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të këtyre fondeve është i papërpunuar, apo dhe i përpunuar jashtë standardeve arkivore.

Është tërësisht e pajustificueshme që një arkivist me formim bazë në histori të mos njohë shkurtimet e fjalëve PPSH (Partia e Punës së Shqipërisë), BRPSH (Bashkimi i Rinisë së Punës së Shqipërisë), BGSh (Bashkimi i Gruas së Shqipërisë), apo aq më tepër të mos njohë etapat e zhvillimit të historisë së Shqipërisë e të mos jetë në gjendje t'i dallojë ndryshimet midis periudhave historike, së paku që nga viti 1912 e deri sot. Mungesa e dijeve, apo mosdëshira për t'u thelluar në elemente të punës së përditshme të arkivistit, bën që të hartohen mjete informacioni me mangësi për të tilla fonde arkivore, duke filluar që nga regjistri i hyrjes së fondeve në arkiva. Është për të ardhur keq, kur vëren se arkivistët nuk njohin figura të shquara të historisë së Shqipërisë, figura që kanë lënë gjurmë në çaste të veçanta të historisë së kombit shqiptar e që në jo pak raste gjenden të shënuar gabim në titujt e dosjeve, skedarë dhe mjete të tjera të informimit të publikut. Një gjë e tillë, përveçse dëmton punën për klasifikimin e dokumenteve, bën institucionin arkivor jo të besueshëm dhe qesharak përpara publikut, studiuesve dhe institucioneve të tjera.

Një tjetër aspekt ku duhet të fokusohet trajnimi dhe formimi i arkivistit do të ishte përgatitja dhe formimi bazuar mbi tipin e fondeve arkivore që administrohen nga arkivi qendror, arkivat shtetërore vendore, arkiva të sistemit, arkiva të së njëjtës tipologji, arkiva të ndërmarrjeve etj. Domosdoshmëri është dhe formimi i arkivistëve në shkenca të tjera: juridike, marrëdhënie ndërkombëtare, të fesë, apo për njohjen e gjuhëve të huaja e në veçanti të shqipes së vjetër (dialektore) apo dhe të shqipes së sotme, pasi shpesh vihen re devijime nga gjuha shqipe e shkruar në atë të

folurën, e kjo, fatkeqësisht, pasqyrohet edhe gjatë punës për hartimin e titujve të dosjeve, të skedarëve apo dhe elementeve të tjerë të punës arkivore.

Sugjerime dhe rekomandime

Meqenëse ky material është përgatitur me rastin e Konferencës së IV Arkivore Mbarëkombëtare, e gjej të rastit të sugjeroj që në kuadër të bashkëpunimit rajonal, sidomos me vendet shqipfolëse, duhet të rritet mundësia e shkëmbimit të përvojës midis arkivistëve. Ashtu siç po bëhen përpjekje për unifikimin e terminologjisë arkivore, për mbajtjen e konferencave të përbashkëta arkivore, duhet të rriten edhe kapacitetet për formimin e arkivistëve në drejtim të klasifikimit dhe mjeteve të kërkimit arkivor. Në shërbim të rritjes së cilësisë profesionale të arkivistëve duhet të organizohen trajnime teorike-praktike për ta unifikuar rritjen e nivelit shkencor tek arkivistët, duke përfshirë më shumë veprimtari praktike për ruajtjen e dokumenteve, menaxhimin dhe shërbimin e tyre nëpërmjet informatikës.

Gjithsesi unë mendoj se një arkivist i cili ka dëshirë t'i përmirësojë teknikat e punës së vet mund të vetëkualifikohet. Arkivisti nuk duhet ta shohë pozicionin e tij të punës thjesht si një administrator i dokumenteve, por si një studiues, si një historian. Ai duhet ta vendosë shpeshherë veten në pozicionin e kërkuesit me qëllim që t'i kuptojë nevojat që ka sot shoqëria ndaj dokumentit, ndaj arkivave. Arkivisti mund ta përmirësojë cilësinë dhe t'i pasurojë njohuritë duke përkthyer literaturë të huaj, të konsultohet me procese pune nga arkiva të tjerë, të përkrahë dhe aplikojë metoda të reja të klasifikimit, regjistrimit, evidentimit dhe shfrytëzimit të dokumenteve arkivore. Një arkivist duhet të jetë në gjendje t'i përcaktojë vetë temat apo kërkesat mbi të cilat ai ka nevojë të kualifikohet dhe jo t'i diktohen nga trajnuesit apo eprorët. Sigurisht se këto nevoja të jenë në përputhje me proceset e punës së përditshme të arkivistit e të reflektohen më pas në to.

Mendoj se ka ardhur koha të kalojmë nga trajnimi bazë arkivor në një nivel më të lartë. Pra, gradualisht me trajnimin arkivor bazë i cili përfshin njohuri mbi Ligjin për arkivat, njohuri për punën me dokumente në sekretari dhe arkiva, të kalojmë në përthithjen e njohurive më të avancuara, përfshirë edhe fushën e teknologjisë. Pikë së pari duhet përgatitur një trupë e mirëfilltë trajnuesish, e cila më pas të jetë e aftë t'i përçojë njohuritë dhe dijet e veta te brezat e ardhshëm të arkivistëve. Trajnimet të kryhen në bazë të nevojave dhe fushës së veprimtarisë së institucioneve apo fondkrijuesve, duke marrë në konsideratë tipologjinë e dokumenteve që ruajnë dhe përpunojnë fondkrijuesit.

Bibliografi:

Delmas, Bruno. *La formation des archivistes: Propositions pour un programme d'enseignement à l'école des sciences de l'information de Rabat (ESI)*, Paris, 1978

Galland, Bruno. *La participation de l'archiviste à la recherche historique; un rôle à définir?* *La Gazette des Archives*. Année 2006, no. 204

Nika, Nevila. *Nga vendruajtja në duart e studiuesit: përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve në AQSh, arritje, dështime e sfida për të ardhmen. Roli dhe përgjegjësitë e arkivistit për evidentimin e lëndës arkivore. Arkivat shqiptare, 1-2, viti XVIII, 2017*